



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 korrik 2012

Nr. ref.: RK /271/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastet Nr. KI 133/11

Parashtrues

Holding Company "Deva" SH.A.
Holding Company "Enea" SH.A.
Holding Company "Tregtia" SH.A.
Holding Company "Industria" SH.A.
Holding Company "Ening" SH.A.
Holding Company "Virxhinia" SH.A.
SH.A. "Metaliku"
J.S.C. "Mulliri"
SH.A. "Mishi"
SH.A. "Modeli"
ED "Ediko"

Aksionarët e Holding Company "Emin Duraku" SH.A.
Aksionarët e Holding Company "Ereniku" SH.A.
Aksionarët e Holding Company "Jatex" SH.A.

kundër

Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Holding Company “Deva” SH.A., Holding Company “Enea” SH.A., Holding Company “Tregtia” SH.A., Holding Company “Industria” SH.A., Holding Company “Ening” SH.A., Holding Company “Virxhinia” SH.A., SH.A. “Metaliku”, J.S.C. “Mulliri”, SH.A. “Mishi”, SH.A. “Modeli”, ED “Ediko”, Aksionarët e Holding Company “Emin Duraku” SH.A., Aksionarët e Holding Company “Ereniku” SH.A., Aksionarët e Holding Company “Jatex” SH.A., të përfaqësuar nga z. Linn Slattengren, avokat nga Prishtina.

Palët kundërshtare

2. Palë kundërshtare janë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM) dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit ankohen se janë duke vuajtur shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe të inkorporuara në Konventën Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) Protokollin 1, neni 1 [Të Drejtat Pronësore].
4. Përveç kësaj, parashtruesit kërkojnë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vlerësojë nëse neni 5.3 i Ligjit për AKP-në (Nr. 03/L-067) është jokushtetues.
5. Për më tepër, parashtruesit kërkojnë që Gjykata të lëshojë masë të përkohshme *“drejtuar AKP-së që të përmbahen nga shitja e aseteve të parashtruesve [...]”, “Në mënyrë që të ruhet status quo dhe për të siguruar përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës”*.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesit e parashtruan kërkesën në Gjykatë më 20 tetor 2011.
8. Më 12 janar 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 133/11, e caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 133/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.
9. Më 9 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi AKP-në për parashtrimin e kërkesës.
10. Më 9 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi informacione nga Dhoma e Posaçme lidhur me statusin e lëndëve, e cila u përgjigj më 20 shkurt 2012.
11. AKP-ja ia dërgoi kësaj Gjykate një përgjigje më 21 shkurt 2012.

12. Më 20 mars 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

13. Më 20 gusht 1990, ish-Republika Socialiste e Jugosllavisë (në tekstin e mëtejme: RSFJ), miratoi Ligjin për Kapitalin Shoqëror për ta filluar procesin e transformimit të ekonomisë socialiste të Jugosllavisë në kapitalizëm. Sipas këtij ligji, gjoja, disa ndërmarrje shoqërore (në tekstin e mëtejme: NSH) që gjendeshin në Gjakovë u transformuan në shoqëri aksionare (në tekstin e mëtejme: SH.A).
14. Në vitin 2005 dhe 2006, sipas kërkesës së Holding Company “Deva” SH.A., Holding Company “Enea” SH.A., Holding Company “Tregtia” SH.A., Holding Company “Industria” SH.A., Holding Company “Virxhinia” SH.A., Aksionarët e Holding Company “Emin Duraku” SH.A., Aksionarët e Holding Company “Ereniku” SH.A., Aksionarët e Holding Company “Jatex” SH.A., Gjykata Ekonomike në Prishtinë e urdhëroi Regjistrin e Bizneseve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë t’i regjistronte ato si shoqëri aksionare. Gjykata Supreme e miratoi vendimin e Gjykatës Ekonomike në Prishtinë. Megjithatë, gjoja, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë kurrë nuk i respektoi plotësisht vendimet e gjykatave dhe i regjistroi ato “si ndërmarrje të tjera nën juridiksionin e AKM-së”.
15. Sa u përket procedurave në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme), faktet janë me sa vijon:

Holding Company “Deva” SH.A.

16. Më 10 dhjetor 2010, Holding Company “Deva” SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së, me ç’rast kërkoi anulimin e vendimeve të AKP-së prej 29 prillit 2010 për shpalljen e kësaj kompanie 100% në pronësi shoqërore, verifikimin e statusit të saj si kompani private, anulimin e vendimit për privatizimin e kompanisë dhe një urdhër për masë të përkohshme për ta ndaluar privatizimin e kompanisë.
17. Më 14 shkurt 2011, trupi gjykues i Dhomës së Posaçme e refuzoi kërkesën për dhënien e masës së përkohshme.
18. Më 18 gusht 2011, Holding Company “Deva” SH.A. e parashtrroi kërkesën e dytë për masë të përkohshme në këtë çështje.
19. Më 7 tetor 2011, Dhoma e Posaçme e refuzoi kërkesën për masë të përkohshme me arsyetimin se nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 55 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 për ndryshimin dhe zëvendësimin e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2006/17, zbatimin e Rregullores Nr. 2002/13 për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: UA UNMIK 2008/6). Përveç kësaj, Dhoma e Posaçme theksoi se pasi ajo tashmë kishte vendosur për këtë çështje më 14 shkurt 2011 dhe pasi nuk ka prova të reja të parashtruara me kërkesën e dytë për masë të përkohshme, nuk ka arsye për lejimin e kërkesës për masë të përkohshme.
20. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme më 10 dhjetor 2008 është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company “Jatex” SH.A.

21. Holding Company “Jatex” SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme për ta konfirmuar statusin e saj si SH.A., për ta detyruar AKP-në për ta njohur statusin e saj dhe për ta anuluar vendimin për privatizim të nisur nga AKP-ja në valën e 45-të, më 22 tetor 2010.
22. Më 21 tetor 2010, Dhoma e Posaçme e miratoi kërkesën për masë të përkohshme deri në vendimin përfundimtar të padisë nga Dhoma e Posaçme.
23. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company “Emin Duraku” SH.A.

24. Më 22 korrik 2008, Holding Company “Emin Duraku” SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar që ajo t’ia njihte statusin e saj ligjor si shoqëri aksionare dhe ta lironte këtë kompani nga juridiksioni i AKM-së/AKP-së.
25. Më 2 nëntor 2010, Dhoma e Posaçme e miratoi kërkesën për masë të përkohshme deri në vendimin përfundimtar të padisë nga Dhoma e Posaçme.
26. Më 26 nëntor 2011, AKP ushtroi ankesë në Kolegjin për ankesa kundër vendimit të trupit gjykues për dhënien e masës së përkohshme.
27. Më 19 maj 2011, Kolegji për ankesa e anuloi vendimin e trupit gjykues dhe e urdhëroi atë për të rigjykuar kërkesën për masë të përkohshme.
28. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company “Enea” SH.A.

29. Më 15 tetor 2008, Holding Company “Enea” SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKM-së.
30. Më 19 shtator 2011, AKP njoftoi për privatizimin e kompanisë.
31. Më 26 gusht 2011, kompania ushtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme për masë të përkohshme.
32. Më 23 shtator 2011, Dhoma e Posaçme e miratoi kërkesën për masë të përkohshme deri në vendimin përfundimtar të padisë nga Dhoma e Posaçme.
33. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Aksionarët e Holding Company “Ereniku” SH.A.

34. Më 5 maj 2008, aksionarët e Holding Company “Ereniku” SH.A. ushtruan padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKM-së.

35. Më 18 maj 2011, kompania ushtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme për masë të përkohshme.
36. Më 4 korrik 2011, Dhoma e Posaçme e refuzoi kërkesën për masë të përkohshme.
37. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company “Industria” SH.A.

38. Më 9 maj 2008, Holding Company “Industria” SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKM-së.
39. Më 17 maj 2011, kompania ushtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme për masë të përkohshme.
40. Më 9 qershor 2011, Dhoma e Posaçme e miratoi kërkesën për masë të përkohshme deri në vendimin përfundimtar të padisë nga Dhoma e Posaçme.
41. Më 18 korrik 2011, AKP-ja njoftoi për shitjen e pasurive të të njëjtës kompani dhe, më 2 gusht 2011, kompania ushtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme për masë të përkohshme.
42. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company “Ening” SH.A.

43. Më 19 maj 2011, Holding Company “Ening” SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKP-së.
44. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

SH.A. “Metaliku”

45. Më 26 shtator 2011, SH.A “Metaliku” ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKP-së.
46. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company “Virxhinia” SH.A.

47. Më 21 prill 2008, Holding Company “Virxhinia” SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKM-së. Dhoma e Posaçme e hodhi poshtë padinë si të papranueshme për shkak se avokati kishte dështuar t'i përgjigjej kërkesës për informacione (Vendimi SCC-08-0099, i 9 korrikut 2009). Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi.
48. Më 4 shkurt 2010, Dhoma e Posaçme e hodhi poshtë ankesën si të papranueshme për shkak se ankesa ishte e pakohshme (Vendimi ASC-09-0050).

Holding Company “Tregtia” SH.A.

49. Më 9 maj 2008, Holding Company “Tregtia” SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKM-së. Dhoma e Posaçme e hodhi poshtë padinë si të papranueshme për shkak se avokati kishte dështuar t’i përgjigjej kërkesës për informacione.
50. Dhoma e Posaçme e hodhi poshtë padinë si të papranueshme për shkak se avokati kishte dështuar t’i përgjigjej kërkesës për informacione (Vendimi SCC-08-0129, i 14 janarit 2009). Nuk u ushtrua ankesë kundër këtij vendimi.

SH.A. “Mulliri”, SH.A. “Mishi”, SH.A. “Modeli”, dhe ED “Ediko”

51. Kompanitë SH.A. “Mulliri”, SH.A. “Mishi”, SH.A. “Modeli”, dhe ED “Ediko” janë privatizuar në një datë të pacaktuar.

Pretendimet e parashtruesit

52. Parashtruesit pretendojnë që:

“...
i. Janë disa Shoqëri Aksionare Private të cilat kanë pasur pasuritë e tyre të marrura dhe të shtura nga AKM/AKP. Të ardhurat janë mbajtur në besim-trust, mirëpo së shpejti do të rimbursohen nga Qeveria.
ii. Ka individë privat të cilët pronën private në formë të aksioneve e kanë pas vlerën e shpronësuar në dobi të Qeverisë.
iii. Janë disa Shoqëri Aksionare Private që rrezikojnë ti kënaqë pasuritë e tyre të marrura dhe të shitura nga AKM//AKP.
iv. Në fund, janë disa individë privat të cilëve prona private në formë të aksioneve janë në rrezik të kenë vlerën e shpronësuar në dobi të Qeverisë.
...”

53. Përveç kësaj, parashtruesit “[...] kërkojnë që Gjykata Kushtetuese e Kosovës të vendosë që neni 5.3 i Ligjit për AKP-në (Ligji 03/L-067) shkel [...]” Neni 32 i “[...] Kushtetutës së Kosovës si është aplikuar në atë që rezulton në marrjen e pronës private në shkelje të nenit 1 Protokollit 1.” Parashtruesit pohojnë që efekti i nenit 5.3 të Ligjit për AKP-në siç është zbatuar, i lejon shtetit ta marrë pronën private në mënyrë arbitrare dhe t’ua shesë atë blerësve privatë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

54. Gjykata vëren që parashtruesit ankohen se janë duke vuajtur shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë dhe Protokollin 1, nenin 1 [Të Drejtat Pronësore] të KEDNJ-së. Përveç kësaj, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata të vlerësojë nëse neni 5.3 i Ligjit për AKP-në (Ligji 03/L-067) është jokushtetues.
55. Megjithatë, për të gjykuar për kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

A. Çështja e shterimit të mjeteve juridike

56. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, Aktvendim për Papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI-41/09, i 27 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).
57. Sa i përket kësaj kërkesë, Gjykata vëren që Dhoma e Posaçme ende nuk ka marrë vendim lidhur me padinë e ushtruar në Dhomën e Posaçme nga SH.A. "Metaliku", Holding Company "Ening" SH.A., Holding Company "Industria" SH.A., Aksionarët e Holding Company "Ereniku" SH.A., Holding Company "Enea" SH.A., Holding Company "Emin Duraku" SH.A., Holding Company "Jatex" SH.A. dhe Holding Company "Deva" SH.A.
58. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtuesit nuk i kanë shteruar mjetet juridike që i kanë në dispozicion sipas ligjeve në fuqi në Kosovë në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.

B. Çështja e mbështetjes së kërkesës me prova

59. Sa i përket kërkesës lidhur me Holding Company "Tregtia" SH.A., Holding Company "Virxhinia" SH.A., J.S.C "Mulliri", SH.A "Mishi", SH.A. "Modeli", dhe ED "Ediko" Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të merret me lajthitjet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga Dhoma e Posaçme, përveç nëse dhe për aq sa ajo mund t'i ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Prandaj, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta.
60. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
61. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtuesit e kësaj kërkesë të kenë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).
62. Përveç kësaj, parashtuesit thjesht nuk pajtohen me gjetjet faktike të gjykatave lidhur me rastin e tyre.
63. Përveç kësaj, sa i përket parashtuesit Holding Company "Virxhinia" SH.A., Gjykata vëren që Dhoma e Posaçme konkludoi që parashtuesi nuk kishte ushtruar ankesë brenda afatit ligjor (Vendimi ASC-09-0050, i 4 shkurtit 2010).
64. Sa i përket parashtuesit Holding Company "Tregtia" SH.A., Gjykata vëren që parashtuesi ka mundur të ushtronte ankesë kundër vendimit të Dhomës së Posaçme (Vendimi SCC-08-0129, i 14 janarit 2009), por nuk kishte ushtruar ankesë.

65. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedura të rregullta për ta parandaluar shkeljen e Kushtetutës, ose, nëse ka, për ta korrigjuar shkeljen e një të drejte themelore. Prandaj, parashtruesi i kërkesës që dështon të ndërmarrë ndonjë hap procedural në gjykata të rregullta brenda afateve të caktuara kohore, vetë bart përgjegjësinë nëse rasti i tij shpallet i papranueshëm, pasi kjo do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për kundërshtim të mëtejme të shkeljes.
66. Në fakt, parashtruesit nuk e kanë mbështetur kërkesën në baza kushtetuese dhe nuk kanë ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur nga ai organ publik. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
67. Duke marrë parasysh këtë që u tha më lart, rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhje me rregullin 36 (2) të Rregullores së punës.

C. Çështja e përputhshmërisë së Ligjit për AKP-në me Kushtetutën

68. Sa i përket pyetjes së parashtruesve lidhur me përputhshmërinë e nenit 5.3 të Ligjit për AKP-në (Ligji Nr. 03/L-067) me Kushtetutën, Gjykata vëren që parashtruesit kanë mundur ta ngrinin çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutë në gjykata të rregullta, të cilat janë të autorizuar sipas nenit 113.8 të Kushtetutës t'i referojnë këto çështje në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, në bazë të dokumenteve të dorëzuara, Gjykata vëren që parashtruesit nuk e kanë ngritur çështjen e përputhshmërisë së nenit 5.3 të Ligjit për AKP-në (Ligji Nr. 03/L-067) me Kushtetutën në gjykata të rregullta, prandaj, duke marrë parasysh parimin e subsidiaritetit, Gjykata nuk mund ta shqyrtojë këtë çështje.
69. Duke marrë parasysh këtë që u tha më lart, rezulton që kërkesa si tërësi duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

70. Sa i përket kërkesës së parashtruesve drejtuar Gjykatës për masë të përkohshme, Gjykata i referohet nenit 27 të Ligjit dhe, në veçanti, rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, i cili thotë që, në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme. Megjithatë, duke marrë parasysh që kërkesa u shpall e papranueshme, parashtruesi nuk ka të drejtë, sipas rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, të kërkojë masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, rregullin 36 (2), rregullin 54 (1) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 20 mars 2012, Gjykata Kushtetuese:

VENDOSI


- I. Njëzëri, ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;
- II. Me shumicë, ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike dhe si qartazi të pabazuar;
- III. Njëzëri, ta hedhë poshtë kërkesën për masë të përkohshme;
- IV. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

For 
Iliriana Islami



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani